



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 362 Prot

Lezhë, më 06/05 /2022

VENDIM

Nr. 47, Datë 04 . 05 .2022

PËR

**“FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PRONËS NR 95/11, E REGJISTRUAR NË KARTELËN E PASURIVE TË PALUAJTSHME ME NR VOL 4 FQ 60, ZK 1716, FSHATI GJADËR, INDEKS HARTE 84-C NË FAVOR TË BASHKISË LEZHË”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 23 pika 7, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “ Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 15, nenit 16, të ligjit nr.8743 datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të Shtetit” të ndryshuar , nenit 3 shkronja gj, nenit 5,të ligjit nr 8744 datë 22.02.2001. “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të Shtetit në njësitë e qeverisjes vendore, të ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI :

1. Për fillimin e procedurave për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës nr 95/11, e regjistruar në kartelën e pasurive të paluajtshme me nr. Vol. 4 fq. 60, zk 1716, fshati Gjadër, indeks harte 84-c në favor të Bashkisë Lezhë sipas dokumentacionit bashkëlidhur këtij projektvendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 , të nenit 55 , të ligjit nr . 139/2015 , “ Për vetëqeverisjen vendore ”, të ndryshuar .

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
ERNEST RAKAJ

